



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal Kaçanik**

**01Nr. 16-23342/15**  
**Kaçanik, 31. 07. 2015**

Në bazë të nenit 12.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 e datës 8 qershor 2008), të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-144 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, të nenit 3 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 23/2013-Për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 31 korrik 2015, mori këtë:

#### **VENDIM**

#### **PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË PALËVE NË PROCEDURËN E DHËNIES SË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM**

1. Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim, në përbërje prej 5 (Pesë) anëtarëve, si vijon:
  - 1.1. Kadri Krivenjeva, anëtar i KK nga PDK,
  - 1.2. Raif Kasa, anëtar i KK nga LVV,
  - 1.3. Ukshin Qallaku, anëtar nga ekzekutivi i komunës,
  - 1.4. Hamëz Berisha, anëtar nga ekzekutivi i komunës, dhe
  - 1.5. Mirlinda Hysa anëtar nga shoqëria civile.
2. Detyrat dhe Përgjegjësitë e komisionit të ankesave janë; pranimi i ankesave të paraqitura në vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim dhe shqyrtimi i tyre.

3. Komisioni për shqyrtimin e ankesave ka mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës.
4. Kryesuesi i Komisionit të ankesave zgjidhet me shumicë votash të anëtarëve të komisionit, dhe e kryeson punën e komisionit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Kryetarit të Komunës,
2. Drejtorisë për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
3. Anëtarëve të Komisionit, dhe
4. Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit  
Xhelal Gashi

